

## SHBALLJE POZICIONI VAKANT

**❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE**

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektesh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

**❖ TITULLI I POZICIONIT TË PUNËS**

Specialist Preventivues

**❖ DETYRAT KRYESORE**

- Te asistojë në përgatitjen e dokumentacionit për pjesëmarrje në tenderat e projekteve të ndryshme;
- Nxjerrja e volumeve për zërat e punës për hartimin e preventivave për objektet me vetefinancim, sipas projektit;
- Hartim analiza të ndryshme cmimi në bazë të normave faktike të kronometruara në kantiere, si dhe norma të përlogaritura në bazë të eksperiencës së punëve të ngjashme;
- Llogaritja e volumeve sipas projektit të sjellë nga autoriteti kontraktues, nxjerrja e volumeve të ndryshme për njësi;
- Përgatitjen e raporteve të ndryshme javore, mujore;
- Rifreskimin e të dhënave të Database për pjesën e analizave dhe cmimeve të ndryshme të hartuara për zëra të ndryshëm pune;
- Harton proces-verbalet për ndryshimet e kërkuara në projekt nga Klientet për ambientet e kontraktuara, jashtë kushteve të kontratës dhe e depoziton në Zyren e Financës për të evidentuar detyrimet e Klienteve ndaj Shoqërisë;
- Analiza për zëra të rinj punimesh për të cilët del e domosdoshme të hartohet vlerësimi nga e para (si normimi dhe gjetja e cmimeve në treg);
- Përgatitja e paketeve për prokurim në fazë tenderimi për zëra për të cilët është e nevojshme marrja e ofertave kur nuk ka cmime referencë ose të perdrituesuara;
- Vlerësimi i ofertave të sjellë nga nenkontraktore të ndryshëm, krahasimi me cmime/analiza të mëparshme për zëra pune të njëjta;
- Studimi i projektit, specifikimeve teknike, vendndodhjes së objektit, pikave të ndryshme ku mund të behen furnizimet me materialet kryesore për tenderin ku do të marrë pjesë kompania.

**❖ KRITERET KRYESORE**

- Diplomë në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit. Profili Inxhinieri Ndërtimi;
- Të ketë mbi 4 vjet eksperiencë në pozicion të ngjashëm;
- Njohuri të mira të gjuhës angleze;
- Njohuri shumë të mira Paketës Office, Autocad;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe të punës në grup;
- Të jetë i gatshëm të udhëtojë/jetojë jashtë Tiranës.
- Te zotërojë patente të klasit B.

Të gjithë të interesuarit, janë të lutur që të dërgojnë CV nëpërmjet adresës së e-mailit [careers@gener2.al](mailto:careers@gener2.al) ose të plotesojnë formularin e aplikimit ne faqen zyrtare [www.gener2.al](http://www.gener2.al) ne seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit është **data 31 Dhjetor 2021, ora 17:00**.

\* Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen.

\* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi “Mbrojtjen e të dhënave personale”.